KËRKESË
Nr.2842/3, datë 30.9.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës "Transballkanike Vlorë".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.872, datë 12.12.2007 dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik".

Vlera totale e këtij shpronësimi është 33 816 000 (tridhjetë e tre milionë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
RRETHI VLORË
BASHKIA VLORË

LISTA E PRONARËVE, PASURITË NË PRONËSI TË TË CILËVE PREKEN NGA RRUGA "TRANSBALLKANIKE", VLORË

Lloji i pasurisë së patundshme: truall

Nr.	Pronari	Nr.pas.	ZK	TRUALL			Shënime
				Sip. m^2	Çmimi lekë/m^2	Vlefta në lekë	
1	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/114	8605	428	12000	5136000	Konfirmuar nga ZRPP
2	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/119	8605	837	12000	10044000	Konfirmuar nga ZRPP
3	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/5	8605	174	12000	2088000	Konfirmuar nga ZRPP
4	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/62	8605	246	12000	2952000	Konfirmuar nga ZRPP
5	Bashkëpronarët Sharra etj.	29/40	8605	889	12000	10668000	Konfirmuar nga ZRPP
6	Bashkëpronarët Sharra etj.	30/10	8605	135	12000	1620000	Konfirmuar nga ZRPP
7	Bashkëpronarët Sharra etj.	30/11	8605	109	12000	1308000	Konfirmuar nga ZRPP
	Totali			2818		33816000	